



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM Nr. 22 datë 25.3.2010

**PËR EMËRIMIN E EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR TË  
SH.A “UJËSJELLËS KANALIZIME“ KORÇË**

Këshilli Bashkiak në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” Neni 135/ç, të Vendimit Nr. 678, datë 03.10.2007 Për një shtesë në Vendimin nr. 271, datë 9.5.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Statutit tip të Shoqërive Anonime, Shtetërore”, të Statutit të Sh.A UKKO Neni 25, si dhe të Ligjit Nr.10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” Neni 42, pasi u njoh me kërkesën për emërim eksperti të Drejtorisë dërguar nga Sh.A UKKO me shkresë Nr. Prot. 60, datë 25.02.2010, si dhe te propozimeve te anetareve te asamblese

**VENDOSI**

1. Të emërojë, për të kontrolluar dhe certifikuar llogaritë vjetore 2009 të Sh.A UKKO. si Ekspertë Kontabël të Autorizuar :

1. znj. Eleonora Telo
2. znj. Etleva Ashiku

Shoqëria para fillimit të punës harton me Ekspertët një projekt-marrëveshje për punën që do të kryhet, me përshkrimin e rubrikave të verifikimeve, kontrolleve, raportimeve etj, për përmbushjen e misionit, orët e punës të parashikuara si dhe honorarin gjithsej.

2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**GJERGJI-PENDAVINJI**